



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEKNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



PLANI

**STRATEGJIK I INSTITUTIT
PEDAGOGJIK TË KOSOVËS**

2026-2030

JANAR 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEKNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



**PLANI STRATEGJIK I INSTITUTIT PEDAGOGJIK TË
KOSOVËS**

2026-2030

JANAR 2026

Ky dokument është hartuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës me mbështetje të Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

PARATHËNIE

Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) paraqet Planin e tij Strategjik 2026–2030, një dokument themelor që përcakton vizionin, misionin, drejtimet strategjike dhe prioritetet e Institutit për pesë vjetët e ardhshëm. Ky plan pasqyron angazhimin tonë për të avancuar kërkimin arsimor, për të forcuar zhvillimin profesional në sektorin e arsimit dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në përmirësimin e politikave dhe praktikave arsimore në Kosovë.

Procesi i hartimit të këtij plani është mbështetur në konsultime të gjera, reflektim institucional dhe analizë të bazuar në prova. Ai është harmonizuar me strategjitë kombëtare të arsimit dhe me standardet ndërkombëtare, duke siguruar që IPK të vazhdojë të jetë një autoritet udhëheqës profesional dhe shkencor në fushën e edukimit. Ky Plan Strategjik është aprovuar nga Këshilli Drejtues i IPK-së në takimin e datës 30 janar 2026.

Në cilësinë e drejtorit, riafirmoj përkushtimin tonë për ta zbatuar këtë plan me integritet, transparencë dhe bashkëpunim. Arritjet e IPK-së do të varen nga angazhimi i stafit tonë, mbështetja e partnerëve tanë dhe besimi i vazhdueshëm i komunitetit arsimor në Kosovë.

Osman Buleshkaj
Drejtore, Instituti Pedagogjik i Kosovës

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
HYRJE.....	7
KONTEKSTI ARSIMOR NË KOSOVË DHE POZICIONIMI I IPK BRENDA SISTEMIT	8
ANALIZA E GJENDJES AKTUALE	9
ANALIZA SWOT	13
VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE PARIMET	15
KORNIZA STRATEGJIKE	16
FUSHAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, AKTIVITETET DHE TREGUESIT	16
ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI	28
BURIMET DHE FINANCIMI	32
SHTOJCAT.....	34
SHTOJCA A: GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT STRATEGJIK	35
SHTOJCA B: PLANI I VEPRIMIT	36
SHTOJCA C: REFERENCA TË MATERIALEVE, PUBLIKIMEVE DHE DOKUMENTEVE LIGJORE	47

LISTA E SHKURTESAVE

ALE NK	Adult Learning and Education Network in Kosovo
CIDREE	Consortium of Institutions for Development and Research in Education in Europe
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EPALE	Electronic Platform for Adult Learning in Europe (Platforma Evropiane Elektronike për të Nxënit e të Rriturve)
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
ISSN	International Standard Serial Number
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
SWOT	Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats (Anët e forta, anët e dobëta, mundësitë, rreziqet)
UNICEF	United Nations International Children's Emergency Fund
VKSHI	Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Inovacion

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani Strategjik i Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK) për periudhën 2026–2030 paraqet drejtimin zhvillimor të Institutit për pesë vjetët e ardhshëm, me synim të forcimit të rolit të tij si institucion qendror i Kosovës në fushën e kërkimit shkencor, sigurimit të mbështetjes profesionale-pedagogjike për DKA-të dhe shkollat, zhvillimin profesional të mësimeve, si dhe mbështetjen e politikave arsimore. Ky plan vendos një kornizë të plotë për forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e cilësisë dhe rëndësisë së kërkimit, përmirësimin e programeve të zhvillimit profesional dhe zgjerimin e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Procesi i hartimit është bazuar në konsultime të vazhdueshme me stafin e IPK-së, MASHTI-n dhe partnerët e tjerë, si dhe është miratuar nga Këshilli Drejtues i Institutit.

Bazuar në analizën SWOT, analizën e dokumenteve strategjike kombëtare si dhe vlerësimin e performancës dhe kapaciteteve të IPK-së gjatë viteve të fundit, grupi punues ka identifikuar katër fusha strategjike, të cilat i mbulojnë të gjitha aspektet e zhvillimit të IPK-së në rrafshin institucional dhe profesional.

Fushat strategjike të IPK-së:

Fusha strategjike	Përshkrimi
Fusha strategjike 1	Hulumtimi, inovacioni dhe reputacioni
Fusha strategjike 2	Zhvillimi profesional-pedagogjik dhe shërbimet mbështetëse
Fusha strategjike 3	Menaxhimi institucional dhe administrimi efektiv
Fusha strategjike 4	Partneriteti dhe rrjetëzimi strategjik

Ky Plan Strategjik shërben si udhërrëfyes për zhvillimin institucional, duke përcaktuar drejtimet strategjike dhe objektivat specifike. Objektivat përkthehen në aktivitete konkrete me tregues të matshëm, të cilët lidhen me një plan zbatueshmërie dhe mbikëqyrjeje që përcakton afatet, bartësit e përgjegjës dhe mënyrën e monitorimit. Plani shoqërohet gjithashtu me një vlerësim të kostove dhe buxhetit, duke marrë parasysh autonominë financiare të kufizuar të IPK-së, për të siguruar realizim efektiv dhe të qëndrueshëm të objektivave strategjike.

HYRJE

Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) është institucion publik i pavarur nën administrimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), i cili ka mandat profesional për të zhvilluar hulumtime, trajnime, vlerësime, analiza, eksperimentime pedagogjike dhe iniciativa inovative në fushën e arsimit. Roli i IPK-së është të kontribuojë drejtpërdrejt në avancimin e cilësisë së arsimit përmes ekspertizës profesionale, orientimit kërkimor dhe mbështetjes së politikave arsimore në nivel kombëtar.

Hartimi i Planit Strategjik të Institutit Pedagogjik të Kosovës 2026–2030 është bazuar në nevojën për të forcuar planifikimin afatgjatë institucional, për të orientuar qartë prioritetet e zhvillimit dhe për të siguruar që mandati dhe përgjegjësitë e IPK-së të realizohen në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Ky proces është udhëhequr duke u mbështetur në dokumentet ekzistuese të funksionimit të IPK-së, si raportet e punës, planet vjetore, diskutimet me ekipin e IPK-së, si dhe strategjitë nacionale të arsimit.

Procesi i planifikimit strategjik për periudhën 2026–2030 është zhvilluar në disa faza të ndërlidhura gjatë një periudhe gjashtëmujore, duke siguruar analiza të thelluara, pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të stafit dhe qartësim të objektivave të institucionit:

Faza I – Analiza fillestare dhe mbledhja e të dhënave

Gjatë fazës së parë është bërë grumbullimi i të dhënave të nevojshme për procesin e planifikimit, duke përfshirë analizat nga raportet e sektorëve, vlerësimet e aktiviteteve, sfidat, arritjet dhe bashkëpunimet me institucionet partnere. Po ashtu, janë ndërmarrë përgatitjet organizative për strukturimin e procesit të hartimit të Planit Strategjik.

Faza II – Analiza dhe konsultimi i stafit

Në këtë fazë është organizuar një punëtori gjithëpërfshirëse me stafin e IPK-së, ku është prezantuar struktura e planit strategjik dhe është realizuar analiza SWOT, duke i identifikuar pikat e forta, sfidat, mundësitë dhe rreziqet në funksionimin e Institutit. Rezultatet e kësaj pune kanë shërbyer si bazë për përshkrimin e gjendjes aktuale.

Faza III – Formulimi i objektivave strategjikë

Bazuar në analizat paraprake, është zhvilluar një punëtori e dytë për të diskutuar dhe finalizuar draftin lidhur me vizionin, misionin, fushat strategjike dhe objektivat, si dhe për të definuar aktivitetet kryesore për secilin objektiv. Po ashtu, është hartuar plani i veprimit dhe vlerësimi orientues i buxhetit të nevojshëm.

Faza IV – Finalizimi i Planit Strategjik

Faza përfundimtare ka përfshirë përpunimin profesional të dokumentit dhe përgatitjen e versionit final të Planit Strategjik 2026-2030, i cili është paraqitur dhe miratuar nga Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës.

KONTEKSTI ARSIMOR NË KOSOVË DHE POZICIONIMI I IPK-së BRENDIA SISTEMIT

Pozicionimi, mandati dhe funksionimi i Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK) është i lidhur në mënyrë të pandashme me realitetin strukturor dhe zhvillimet strategjike të sistemit arsimor në Kosovë. Funksionimi i IPK-së nuk mund të kuptohet vetëm si rezultat i kapaciteteve të brendshme institucionale, por mbi të gjitha përmes ndërveprimit me proceset reformuese, prioritetet e politikave arsimore dhe dinamikën e nevojave të sistemit shkollor në vend. Prandaj, perspektiva e IPK-së duhet të vendoset brenda një kornize të gjerë historike, institucionale e politike, e cila përfshin ndryshimet në rolin e mësimdhënësve, zhvillimin dhe ndryshimin e shkollave, dhe presionin në rritje për avancimin e kërkimit shkencor dhe arsimit të bazuar në dëshmi.

Në dy dekadat e fundit, sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër një transformim të rëndësishëm, i cili fillimisht ka qenë i fokusuar në qasjen strukturore, përfshirë decentralizimin dhe rritjen e qasjes dhe gradualisht është orientuar drejt cilësisë së mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënësve (Kaçaniku, 2022; Saqipi & Hoti, 2019; Saqipi, 2019). Strategjia e Arsimit 2022–2026 në nivel vendi ka tentuar të ndërtojë një arkitekturë të qëndrueshme reformash, duke vënë një theks të veçantë në zhvillimin profesional të mësimdhënësve (Mehmeti, 2024), modernizimin kurrikular (Buleshkaj & Koren, 2022; Nikoçeviq-Kurti, Saqipi, & Kaçaniku, 2025; Tahirsylaj, 2018), digjitalizimin dhe krijimin e kapaciteteve institucionale për monitorim dhe vlerësim të rezultateve (Terziu & Buleshkaj, 2023), si dhe fuqizimin e kërkimit shkencor (Kaçaniku, 2018) dhe politikëbërjes së bazuar në dëshmi si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit. Në këtë perspektivë, IPK luan rol kritik si institucion që prodhon njohuri sistematike dhe mbështetje profesionale për zbatimin e këtyre politikave nga shkollat dhe stafi mësimdhënës.

Reforma kurrikulare mbetet shtylla qendrore e transformimit të arsimit në Kosovë (Buleshkaj & Koren, 2022). Që nga vendosja e saj në vitin 2011 e deri te rishikimet e mëvonshme në vitin 2016, kjo reformë ka kërkuar ndryshime të thella në planifikimin e mësimdhënies, vlerësimin e nxënësve dhe rritjen e cilësisë së procesit mësimor (Mehmeti et al., 2019; Mehmeti et al., 2022). Kalimi nga qasja e orientuar në objektiva drejt qasjes së bazuar në kompetenca ka vendosur kërkesa të reja për mësimdhënësit, duke e bërë të domosdoshëm një sistem të strukturuar mbështetjeje profesionale që i tejkalon format klasike të trajnimit dhe që përfshin: mentorim, këshillim pedagogjik, vëzhgim të praktikës, reflektim profesional dhe ndërtim të kulturës së zhvillimit të vazhdueshëm në shkollë (Tahirsylaj, 2018; Terziu & Buleshkaj, 2023; Saqipi, 2019). Kjo qasje kërkon një nivel të lartë profesionalizmi, mentorimi dhe mbështetje institucionale të vazhdueshme në shkolla, aty ku IPK ka rol të drejtpërdrejtë përmes mandatit të tij ligjor për shërbime pedagogjike-profesionale dhe përmes pilotimeve zhvillimore.

Një prej proceseve kyçe plotësuese të reformës është sistemi i licencimit dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve, i përcaktuar me Kornizën Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve (MASHTI, 2017) dhe mekanizmat rregullativë për avancimin në karrierë, të cilët së fundmi janë konsoliduar edhe përmes Udhëzimit Administrativ për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve (MASHTI, 2023a) dhe Udhëzimit Administrativ për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie (MASHTI, 2023b). Ky sistem kërkon që profesionalizimi i mësimdhënësve të mbështetet në standardet e kompetencave, zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe vlerësimin sistematik të performancës. Megjithatë, zhvillimi profesional deri më sot ka qenë kryesisht i fragmentar, i varur nga projekte afatshkurtra dhe jo i institucionalizuar në mënyrë të qëndrueshme, çka e lë sistemin pa një mekanizëm vendor që i lidh politikën me praktikën në shkolla (Saqipi, 2019; Mehmeti, 2024). Në këtë kontekst, IPK ka potencialin dhe mandatin e duhur për ta shndërruar kornizën e zhvillimit profesional në praktikë të prekshme përmes modeleve pilotuese, trajnimit-veprimit, instrumenteve dhe udhëzimeve metodologjike, vlerësimit të progresit profesional, hulumtimeve në veprim dhe modelimit të praktikave efektive në shkolla.

Në të njëjtën linjë, zhvillimi i kërkimit shkencor arsimor paraqitet si një domosdoshmëri sistemike për të mbështetur planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, si dhe për të siguruar marrëdhënie të qëndrueshme midis reformave dhe realitetit të praktikës. Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (2013) dhe Programi Kombëtar i Shkencës (2023) e pozicionojnë kërkimin shkencor si bazë të zhvillimit socio-ekonomik, mirëpo kërkimi arsimor mbetet ende më i zhvilluar në nivel individual apo të projekteve sesa institucional (Kaçaniku, 2018). Në këtë aspekt, IPK ka një rol unik si institucion publik i specializuar në kërkimin arsimor dhe pedagogjik aplikativ, me potencial të konsiderueshëm për t'u zhvilluar si njëra nga qendrat kombëtare të evidencës dhe mbështetjes shkencore për politikëbërjen arsimore. Kjo nënkupton që IPK duhet të veprojë si gjenerator i të dhënave, analizave, hulumtimeve krahasuese dhe rekomandimeve politike që e mbështesin MASHTI-n dhe shkolat në marrjen e vendimeve të informuara (Rexhaj, 2022). Përmbushja e këtij roli kërkon kapacitete të zhvilluara kërkimore, staf shkencor adekuat, rrjete bashkëpunimi dhe mekanizma efektivë publikimi e shpërndarjeje, elemente këto që ky Plan Strategjik synon t'i forcojë.

Prandaj, në këtë kontekst kompleks dhe dinamik të reformave, pritjet karshi IPK-së janë jo vetëm të natyrës operative, por sistemike, që të udhëheqë metodologjikisht proceset e ndryshimit në shkolla, të forcojë kapacitetet profesionale të mësimdhënësve, të gjenerojë evidencë shkencore të besueshme, të kontribuojë në hartimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe të bëhet qendër e ekspertizës kombëtare për kërkimin pedagogjik dhe inovacionin didaktik në Kosovë.

ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Botimet e IPK-së

IPK ka krijuar një fond të pasur me publikime, me mbi 50 tituj të disponueshëm deri më tani, të cilët mund të konsultohen drejtpërdrejt përmes faqes zyrtare të Institutit <https://ipkmasht.rks-gov.net>. Ky fond përfshin botime nga periudha të ndryshme që nga themelimi i Institutit deri më sot e që trajtojnë tema të rëndësishme për arsimin: pedagogji, standarde arsimore, vlerësim të nxënësve dhe mësimdhënësve, politika arsimore, zhvillim profesional, reforma të ndryshme arsimore, integrim social dhe çështje të tjera që ndikojnë në zhvillimin e sistemit arsimor.

Botimet e IPK-së janë një burim i vlefshëm për mësimdhënësit, drejtuesit e shkollave, autorët e kurrikulave, studentët dhe studiuesit, duke u mundësuar atyre të përmirësojnë praktikën mësimore, të zhvillojnë strategji të reja arsimore dhe të përdorin njohuritë e fituara për plane mësimore, analiza dhe reforma konkrete. Dokumentet mund të shërbejnë gjithashtu si referenca të besueshme për studime shkencore dhe për vendimmarrje në politikën arsimore.

Për publikun e gjerë, këto publikime ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi gjendjen e arsimit në Kosovë, duke evidentuar sfidat, problematikat dhe mundësitë për ndryshim. Në këtë mënyrë, IPK kontribuon jo vetëm në avancimin e arsimit për profesionistët e fushës, por edhe në rritjen e informimit dhe vetëdijes së shoqërisë për zhvillimet dhe nevojat e sistemit arsimor kosovar.

Revista “Kërkime Pedagogjike”

Revista “Kërkime Pedagogjike” e Institutit Pedagogjik të Kosovës ka për qëllim të promovojë kërkimin shkencor dhe zhvillimin profesional në fushën e arsimit, duke krijuar një hapësirë të qëndrueshme për publikimin e studimeve, analizave dhe praktikave bashkëkohore pedagogjike. Përmes përmbajtjes së saj, revista synon të forcojë bazën e evidencave në të cilën mbështeten politikat arsimore, të nxisë shkëmbimin e njohurive ndërmjet studiuesve dhe

profesionistëve të arsimit, si dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënësve në Kosovë. Botimet e revistës shërbejnë si burim i rëndësishëm për studiues, mësimdhënës, politikëbërës dhe institucione arsimore, duke ofruar perspektiva të reja dhe rekomandime të bazuara në hulumtim. Të gjithë numrat e revistës janë të qasshme në faqen: https://albanica.al/kerkime_pedagogjike/index.

Botimet e veçanta të IPK-së

Botimet e veçanta të Institutit Pedagogjik të Kosovës paraqesin publikime analitike, raporte dhe dokumente mbështetëse për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave arsimore në nivel qendror dhe lokal. Këto botime adresojnë prioritetet strategjike të sistemit arsimor, duke ofruar dëshmi të bazuar në kërkime, analiza të praktikave ekzistuese dhe rekomandime konkrete për vendimmarrje. Në funksion të përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale, këto botime shërbejnë si referencë profesionale për MASHTI-n, Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe aktorët e tjerë relevantë në planifikimin, monitorimin dhe zhvillimin e reformave arsimore. Botimet janë të qasshme përmes faqes zyrtare të Institutit: <https://ipkmasht.rks-gov.net>.

Programet e trajnimit nga IPK-ja

Sipas mandatit dhe misionit të IPK-së, ky institucion ofron shërbime profesionale me rëndësi të veçantë për mësimdhënësit dhe institucionet arsimore, si programe trajnimi për ngritje kapacitetesh në nivel të shkollave dhe DKA-ve. Trajnimet kanë për qëllim të mbështesin zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave, përmirësimin e praktikave mësimore, harmonizimin me standardet arsimore dhe zbatimin e politikave dhe reformave në arsim.

Lista me programet trajnuese është paraqitur në tabelën në vijim:

Programi / Trajnimi	Përshkrimi / Qëllimi kryesor
1. Bashkëpunimi cilësor Edukatore-Prind në institucionet parashkollore	Synon të përforcojë bashkëpunimin mes edukatoreve dhe prindërve në institucionet parashkollore, për një mjedis më të mirë edukimi dhe zhvillimi për fëmijët.
2. Shkolla gjithëpërfshirëse që mbështet arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe të riatdhesuarve	Një program për përfshirje sociale dhe arsim gjithëpërfshirës, me qëllim që t'u ofrojë mundësi të barabartë arsimore komuniteteve dhe grupeve pakicë.
3. Qasja metodologjike në mësimdhënien e gjuhës angleze në shkolla fillore përmes Hulumtimit në Veprim	Trajnim për mësimdhënësit e gjuhës angleze në shkolla fillore, me fokus në metoda bashkëkohore, praktika aktive të mësimdhënies dhe përdorim të hulumtimit në praktikë.
4. Trajnimi i mësimdhënësve të shkollave të mesme profesionale për punë me të rritur	Program për mësimdhënësit që punojnë në arsimin profesional, në mënyrë që të aftësohen për punë më efektive me nxënës/të rritur.
5. Identifikimi i nxënësve me vështirësi në shkrim-lexim dhe ofrimi i mbështetjes për tejkalimin e vështirësive	Trajnim për mësimdhënës dhe edukatorë për të njohur dhe mbështetur nxënësit me vështirësi në shkrim-lexim, për të ofruar ndihmë adekuate dhe për të përmirësuar mësimin.
6. Përgatitja e Edukatorëve Parafillorë për përkrahjen dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitetit	Program për edukatorët/parashkollorët me fokus në zhvillimin e fëmijëve përmes lojës, kreativitetit dhe qasjeve zhvillimore.

7. Vlerësimi i performancës së shkollës	Trajnim/metodologji për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore, për të siguruar standarde dhe cilësi në mësimdhënie dhe menaxhim.
8. Menaxhimi i cilësisë në shkollë	Program për drejtuesit e shkollave dhe stafin menaxhues, për të ndërtuar dhe zbatuar sisteme të sigurisë së cilësisë në arsim.
9. Përgatitja dhe përdorimi i materialeve mësimore	Trajnim për zhvillimin dhe përdorimin e materialeve didaktike, për të përmirësuar mësimdhënien dhe për të përshtatur përmbajtjet mësimore sipas nevojave.

Konferencat, simpoziumet dhe ngjarjet e tjera

IPK ka zhvilluar dhe vazhdon të organizojë një numër të konsiderueshëm aktivitetesh shkencore dhe konferencash, duke krijuar një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e njohurive, debatit akademik dhe promovimit të hulumtimeve pedagogjike.

Në periudhën 2019–2025, IPK ka organizuar 7 konferenca shkencore ndërkombëtare me prezantues vendorë dhe ndërkombëtarë, ku mesatarisht secila konferencë ka tërhequr rreth 150 pjesëmarrës. Kjo tregon një konsistencë në përkushtimin për të ofruar një hapësirë profesionale për diskutim mbi çështje të ndryshme të arsimit dhe pedagogjisë, si dhe për integrimin e praktikave ndërkombëtare në kontekstin lokal.

Përveç konferencave ndërkombëtare, IPK ka organizuar gjithashtu një sërë aktivitetesh të tjera shkencore, duke përfshirë simpoziume, prezantime njëditore dhe tryeza shkencore. Fillimisht, këto aktivitete ishin kryesisht të limituara, zakonisht një simpozium ose konferencë për prezantimin e raporteve në vit, duke shërbyer si mundësi për publikimin dhe diskutimin e punimeve hulumtuese. Megjithatë, dy vjetët e fundit (2024–2025), këto aktivitete kanë shënuar një rritje të ndjeshme të intensitetit dhe larmisë së aktiviteteve. Në vitin 2024, u organizua një simpozium shkencor mbi “Integrimin e artit dhe dramës në edukim”, ndërsa në vitin 2025 u zhvilluan 4 simpoziume shkencore, 6 tryeza diskutimi me Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe 3 evente të veçanta për Javën e të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës.

Kjo rritje në numër dhe diversitet tregon për një angazhim të shtuar të IPK-së në promovimin e shkencës arsimore, përfshirjen e aktorëve të ndryshëm arsimorë dhe për krijimin e hapësirave interaktive për diskutim, shkëmbim përvojash dhe reflektime kritike mbi praktikën pedagogjike dhe politikën arsimore në Kosovë. Në përgjithësi, këto aktivitete nuk shërbejnë vetëm si platforma për hulumtime dhe prezantime shkencore, por edhe si instrumente strategjike për rritjen e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve, të drejtuesve dhe aktorëve të tjerë arsimorë, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe integrimin e praktikave të mira lokale dhe ndërkombëtare në sistemin arsimor të Kosovës.

Partneritetet vendore dhe ndërkombëtare

Instituti Pedagogjik i Kosovës zhvillon dhe konsolidon partneritete të qëndrueshme me aktorët kyç të sektorit të arsimit, me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale, avancimin e kërkimit shkencor dhe mbështetjen e proceseve të ndryshme në sistemin arsimor të Kosovës. Bashkëpunimet strategjike përfshijnë Fakultetin e Edukimit, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, si dhe një numër organizatash joqeveritare që veprojnë në Kosovë, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e politikave, programeve dhe mbështesin aspekte të ndryshe të arsimit dhe avancimit të cilësisë së mësimdhënies.

Gjithashtu, IPK synon të forcojë rolin e tij në rrjetëzimin profesional përmes bashkëpunimit me Rrjetin EPALE, Rrjeti për të Nxënërit dhe Arsimin për të Rritur në Kosovë – ALE NK, duke siguruar qasje në praktika bashkëkohore të të nxënërit të të rriturve, shkëmbimin e ekspertizës dhe përfshirjen në komunitetet evropiane të praktikës profesionale. Këto partneritete, por edhe bashkëpunimet me institucionet dhe organizatat e tjera vendore, mbështesin objektivat strategjike të Institutit dhe kontribuojnë në realizimin e misionit të tij për ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Instituti Pedagogjik i Kosovës kultivon partneritete të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat e forcojnë kapacitetin institucional dhe e vendosin IPK-në në rrjete të avancuara evropiane dhe globale të zhvillimit arsimor. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, si Save the Children, UNICEF, British Council dhe CARITAS, ka mundësuar zhvillimin e programeve që adresojnë përfshirjen, barazinë, mësimdhënien cilësore dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe të edukatoreve të nivelit parashkollor. Ndërsa, përmes projektit EU KosED, Instituti ka përfituar mbështetje në fushën e reformave kurrikulare, me theks të veçantë në ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve për përmirësimin e teksteve shkollore.

Një komponent tjetër strategjik i bashkëpunimit ndërkombëtar është përfshirja e IPK-së në rrjete profesionale si CIDREE, që mundëson shkëmbimin e ekspertizës dhe praktikave inovative me institucionet homologe në Evropë. Po ashtu, Programi Fulbright Specialist kontribuon në forcimin e ekspertizës kërkimore-shkencore dhe zhvillimin e projekteve transformuese brenda institucionit. Jo vetëm këto, por edhe partneritetet e tjera ndërkombëtare janë thelbësore për avancimin e rolit të IPK-së si institucion udhëheqës në zhvillimin e politikave dhe përmirësimin e praktikave arsimore në vend.

ANALIZA SWOT

IPK ka ndërtuar ndër vite një pozicion të konsoliduar dhe të respektuar në komunitetin akademik dhe arsimor në Kosovë dhe më gjerë. Si institucion me traditë të gjatë në fushën e kërkimit dhe zhvillimit arsimor, IPK gëzon besueshmëri të lartë institucionale, të cilën e ka fituar falë profesionalizmit të stafit, përkushtimit ndaj cilësisë dhe strukturës së qëndrueshme organizative. Standardet e larta akademike dhe etika profesionale përbëjnë bazën e suksesit të Institutit dhe e bëjnë atë një aktor të rëndësishëm në proceset e zhvillimit arsimor në vend.

IPK angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në aktivitete kërkimore-shkencore, duke realizuar studime dhe publikime në revista të indeksuara ndërkombëtarisht, që trajtojnë çështje thelbësore të arsimit në Kosovë. Përmes konferencave, simpoziumeve dhe tryezave shkencore, Instituti promovon shkëmbimin e njohurive, diskutimin profesional dhe përhapjen e rezultateve të kërkimeve në mesin e komunitetit arsimor.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet arsimore vendore, IPK ka zhvilluar një rol aktiv në përkrahjen e shkollave dhe Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) në fushën e zhvillimit profesional të mësimit të nivelit parauniversitar. Përmes trajnimeve, këshillimeve dhe asistencës teknike, Instituti kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mësimit dhe të rezultateve arsimore, duke forcuar lidhjen ndërmjet kërkimit shkencor dhe praktikës mësimore.

Punëtorët shkencorë të IPK-së e përfaqësojnë Institutin në konferenca dhe forume ndërkombëtare, duke prezantuar punime shkencore që rrisin dukshmërinë dhe ndikimin e Institutit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Kjo pjesëmarrje aktive në rrjete profesionale dhe shkencore mundëson rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimin e përvojave dhe integrimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në kontekstin arsimor të Kosovës.

Në aspektin institucional, IPK funksionon në bazë të një kornize të qartë ligjore, e cila i garanton status të veçantë dhe autonomi profesionale si qendër e specializuar për hulumtime dhe zhvillim të politikave arsimore. Ky status e pozicionon IPK-në si një institucion kyç në procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave të arsimit në nivel kombëtar.

Pavarësisht të gjitha anëve të forta dhe arritjeve të cekura më lart, IPK ende përballet me një sërë sfidash strukturore, organizative dhe funksionale, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe ndikimin e tij në sistemin arsimor të vendit. Një nga sfidat kryesore mbetet mungesa e selisë së përhershme dhe e hapësirave adekuate për bibliotekë, arkiv, qendra kërkimore dhe hapësira për punëtorë profesionale. Kjo gjendje kufizon mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm institucional dhe profesional, si dhe e vështirëson krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për punë kërkimore dhe bashkëpunim akademik. Po ashtu, buxheti i paqëndrueshëm dhe shpesh i pamjaftueshëm e bën të vështirë planifikimin afatgjatë, menaxhimin strategjik të projekteve dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja institucionale. Një tjetër sfidë e ndjeshme është mungesa e stafit të specializuar në disa departamente mbështetëse dhe në administratë, çka e kufizon aftësinë e IPK-së për të menaxhuar projekte vendore dhe ndërkombëtare, për të përmirësuar proceset e brendshme të menaxhimit dhe për të promovuar rezultatet e punës kërkimore. Kjo situatë ndikon gjithashtu në kapacitetet e Institutit për të reaguar ndaj kërkesave të sistemit arsimor dhe në dobësimin e bashkëpunimit me partnerët institucionalë.

Një hendek shtesë është mospërdorim i plotë i rezultateve kërkimore në proceset e politikëbërjes dhe në fushat prioritare të zhvillimit arsimor kombëtar. Një përfundim i tillë ka dalë nga hulumtimi "Jetësimi i rekomandimeve të hulumtimeve nga Instituti Pedagogjik i Kosovës për Arsimin e të rriturve në politikat dhe praktikat e këtij komponenti" (Zylfiu, 2025). Kjo tendencë rrezikon të reduktojë relevancën praktike dhe ndikimin e Institutit në hartimin dhe zbatimin e reformave arsimore. Për rrjedhojë, mundësitë e bashkëpunimit dhe koordinimit

ndërinstitucional mbeten të kufizuara, duke reflektuar edhe në numër të vogël të aplikimeve për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Si rezultat i gjetjeve që tregojnë mospërdorim dhe mosjetësim të plotë të rezultateve kërkimore në proceset e politikëbërjes dhe praktikave për ARr-në, është e nevojshme që IPK të zbatojë qasjen e partneritetit hulumtues-zbatues praktik në fazat e hulumtimeve, për të përafuar zbatimin praktik të gjetjeve dhe rekomandimeve nga hulumtimet për këtë komponent.

Megjithatë, IPK gëzon potencial të madh për rritje, inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ekziston një bazë solide mbi të cilën mund të ndërtohen transformime strategjike, të fokusuara në forcimin e kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore dhe institucionale. Përforcimi i departamenteve me staf shtesë dhe qartësimi i roleve e përgjegjësive mund ta rrisin efikasitetin e punës dhe bashkëpunimin ndërsektorial brenda Institutit. Po ashtu, investimi në trajnime të specializuara në fushat e kërkimit shkencor, analizës statistikore dhe politikave arsimore do të kontribuonte në rritjen e kompetencës profesionale dhe në forcimin e rolit të IPK-së si qendër kombëtare e ekspertizës në arsim. Për më tepër, statusi kërkimor-shkencor i IPK-së, si dhe botimet me ISSN, ofrojnë potencial për tërheqjen e studiuesve, bashkëpunëtorëve dhe botuesve të jashtëm, duke e forcuar reputacionin dhe ndikimin shkencor të Institutit në rajon dhe më gjerë. Një tjetër mundësi me rëndësi strategjike është zhvillimi i shërbimeve digjitale, trajnimeve online dhe uebinareve, që mund të rrisin dukshmërinë dhe ndikimin kombëtar e ndërkombëtar të IPK-së, duke e bërë Institutin më të qasshëm dhe më relevant me trendet bashkëkohore në arsim.

Në përfundim, IPK mbetet një institucion me reputacion të fortë dhe potencial të madh zhvillimi. Mirëpo, për të ruajtur relevancën, rritur ndikimin dhe zgjeruar veprimtarinë e tij, është e domosdoshme të adresohen në mënyrë sistematike sfidat infrastrukturore, financiare dhe njerëzore. Përmes menaxhimit strategjik, planifikimit afatgjatë dhe promovimit të kapaciteteve institucionale, IPK mund ta konsolidojë më tej rolin e tij si shtyllë qendrore në zhvillimin e politikave dhe praktikave arsimore në Kosovë.

VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE PARIMET

Procesi i rishikimit të vizionit, misionit dhe vlerave të Institutit është zhvilluar në mënyrë të strukturuar, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt modernizimit të rolit të institucionit. Ky proces ka përfshirë analizën e mandateve ligjore të IPK-së, shqyrtimin e dokumenteve strategjike kombëtare të arsimit, konsultimet me stafin hulumtues dhe pedagogjik, si dhe diskutimet e hapura në punëtori të dedikuara për të reflektuar realitetin aktual dhe orientimet e së ardhmes. Rishikimi ka synuar të sigurojë që vizioni të pasqyrojë qartë drejtimin zhvillimor të Institutit, që misioni të përshkruajë funksionin e tij thelbësor në sistemin arsimor, dhe që vlerat të përfaqësojnë parimet etike dhe profesionale mbi të cilat mbështetet puna e IPK-së. Si rezultat, IPK ka përditësuar vizionin, misionin dhe vlerat e veta në përputhje me standardet moderne, nevojat e sistemit arsimor dhe objektivat strategjike për periudhën 2026–2030.

Vizioni

Institucion publik kërkimor – shkencor i rëndësisë së veçantë, për hulumtime në shkencat e edukimit dhe për mbështetje profesionale-pedagogjike në fushën e arsimit në Kosovë.

Misioni

Realizimi i hulumtimeve të avancuara kërkimore-shkencore në fushën e shkencave të edukimit, si dhe ofrimi i shërbimeve pedagogjike-profesionale për nevojat e sistemit arsimor të Kosovës përmes partneritetit dhe bashkëpunimit me institucionet kërkimore-shkencore, pedagogjike e profesionale dhe institucionet e tjera arsimore, vendore e ndërkombëtare.

Vlerat tona të përbashkëta:

- *Etika profesionale dhe integriteti shkencor;*
- *Gjithëpërfshirja, përgjegjshmëria dhe respekti;*
- *Transparenca dhe llogaridhënia;*
- *Bashkëpunimi dhe partneriteti;*
- *Përkushtimi dhe profesionalizmi;*
- *Objektiviteti, origjinaliteti dhe cilësia;*
- *Besueshmëria, ambicia dhe kreativiteti.*

Parimet e punës në IPK:

- *Përkushtimi në realizimin e vizionit dhe misionit të Institutit;*
- *Udhëheqja bashkëpunuese përmes modelimit;*
- *Korrektesia dhe respekti në raportet hierarkike dhe kolegjiale;*
- *Gjithëpërfshirja e punonjësve në proceset zhvillimore dhe në vendimmarrje;*
- *Zhvillimi i kolegjalitetit dhe kulturës bashkëpunuese të orientuar në ndryshim;*
- *Transparenca në vendimmarrje dhe në menaxhimin e Institutit;*
- *Kërkimet cilësore dhe inovative;*
- *Mbështetja pedagogjike-profesionale dhe zhvillimi i vazhdueshëm.*

KORNIZA STRATEGJIKE

FUSHAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, AKTIVITETET DHE TREGUESIT

Plani Strategjik i IPK-së 2026–2030 është hartuar për të siguruar një orientim të qartë dhe të strukturuar mbi mënyrën se si do të realizohen objektivat strategjike të institucionit. Ai përfshin një përshkrim të detajuar për objektivat strategjike dhe specifike, aktivitetet kryesore dhe afatet kohore të zbatimit, përgjegjësit për secilën veprimtari, burimet e nevojshme dhe treguesit e suksesit.

Plani synon që secili aktivitet të jetë i matshëm, i qartë dhe i lidhur drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së arsimit, zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe pedagogjike, si dhe forcimin e menaxhimit dhe bashkëpunimeve strategjike të institucionit. Për secilin objektiv specifik, janë identifikuar aktivitete të konkretizuara, duke filluar nga organizimi i seminareve dhe projekteve kërkimore-shkencore, trajnimeve profesionale për punonjësit e arsimit, përmirësimin të infrastrukturës dhe kapaciteteve administrative, deri te ndërtimi i rrjeteve dhe partneriteteve strategjike me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në vijim janë paraqitur vetëm objektivat strategjike dhe specifike së bashku me aktivitetet kryesore dhe treguesit e suksesit. Ndërsa, në **shtojcën A** është paraqitur tabela e plotë (*Plani i Veprimit*), i cili përfshin afatet për secilin aktivitet kryesor, personelin përgjegjës dhe burimet. Në këtë formë, plani mundëson monitorimin dhe vlerësimin e progresit në mënyrë të qartë, duke garantuar që çdo objektiv strategjik të realizohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Institutit.

Fusha Strategjike 1	Hulumtimi, inovacioni dhe reputacioni
Objektivi Strategjik 1.1	Rritja dhe avancimi i kërkimit shkencor dhe inovativ të IPK-së, si dhe forcimi i reputacionit vendor dhe ndërkombëtar përmes bashkëpunimeve të reja, publikimeve, digjitalizimit, promovimit të punës kërkimore-shkencore dhe pjesëmarrjes në projekte shkencore.

Objektivi Strategjik 1.1 ka rëndësi thelbësore për Planin Strategjik të Institutit Pedagogjik të Kosovës 2026–2030, pasi përfaqëson boshtin kryesor të zhvillimit të Institutit si qendër kombëtare e dijes, inovacionit dhe ekspertizës profesionale në fushën e edukimit. Përqendrimi në rritjen dhe avancimin e kërkimit shkencor jo vetëm që fuqizon kapacitetet e brendshme kërkimore, por gjithashtu forcon reputacionin vendor dhe ndërkombëtar të IPK-së përmes publikimeve cilësore, digjitalizimit të proceseve dhe zgjerimit të bashkëpunimeve akademike e profesionale. Promovimi i rezultateve kërkimore dhe angazhimi në projekte shkencore krijon mundësi të reja për inovacion, rrit ndikimin e Institutit në politikat arsimore dhe kontribuon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së sistemit arsimor në Kosovë.

Objektivi Specifik 1.1.1 Avancimi i kapaciteteve kërkimore-shkencore të stafit të IPK-së**Aktivitetet kryesore**

1. Zhvillimi i moduleve për punë kërkimore me fokus në etikë shkencore, metodologji të kërkimit, dizajnim të studimeve, instrumente për mbledhjen e të dhënave, etj.;
2. Organizimi i trajnimeve për avancimin e aftësive kërkimore për stafin e IPK-së;
3. Trajnime për SPSS, NVivo, JASP dhe mjete të AI për analizë statistikore dhe përpilim të raporteve shkencore;
4. Hartimi i udhëzuesit institucional për përdorimin etik të AI;
5. Ngritja e një sistemi të brendshëm të komunikimit dhe ndarjes së materialeve/resurseve profesionale.

Treguesit e suksesit

- Modulet e zhvilluara;
- Trajnimet e organizuara;
- ≥70% staf i trajnuar;
- Udhëzuesi i hartuar;
- Sistemi i brendshëm, i ngritur dhe funksional;

Objektivi Specifik 1.1.2 Zhvillimi i projekteve kërkimore shkencore-ndërdisciplinare vendore dhe ndërkombëtare**Aktivitetet kryesore**

1. Përfshirja aktive e punëtorëve shkencorë në realizimin e projekteve ndërdisciplinare;
2. Prioritizimi i temave të projekteve sipas Planit Kombëtar të Shkencës, Strategjisë së Arsimit dhe trendeve ndërkombëtare;
3. Hartimi i projekteve kërkimore-shkencore dhe aplikimi sipas kalendarit vjetor të thirrjeve për projekte vendore nga MASHTI dhe MKRS-ja;
4. Krijimi i partneriteteve me institutet e edukimit dhe universitetet e rajonit dhe të BE-së;
5. Hartimi i udhëzuesit për projekte shkencore ndërdisciplinare dhe dorëzimi i aplikimeve për thirrjet e ndryshme në projekte ndërkombëtare.

Treguesit e suksesit

- % e stafit të përfshirë në realizimin e projekteve ndërdisciplinare sipas normës së dakorduar (shih 3.1.2);
- Lista me temat e prioritizuara;
- Numri i projekteve të hartuara;
Numri i projekteve të dorëzuara në thirrjet e hapura nga MASHTI dhe MKRS-ja në temat prioritare për IPK-në;
- Numri i partneriteteve të reja;
- Numri i projekteve të hartuara;
Numri i projekteve të dorëzuara në thirrjet e hapura ndërkombëtare me temat prioritare për IPK-në;

Objektivi Specifik 1.1.3 Hartimi i projekteve kërkimore për gjithëpërfshirjen dhe barazinë në arsim

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Hulumtime mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe barazinë në mësimdhënie; 2. Hartimi dhe pilotimi i projekteve dhe zhvillimi i udhëzuesve për mësimdhënës dhe për menaxhmentin e shkollës; 3. Hartimi i raporteve dhe rekomandimeve për rishikim të politikave për gjithëpërfshirjen në arsim; 4. Realizimi i projekteve kërkimore dhe zhvillimore në bashkëpunim me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i përcaktuar për hulumtimime për gjithpërfshirje; Hulumtimet e realizuara; • Numri i projekteve të pilotuara; Numri i udhëzuesve të zhvilluar; • Raporti me rekomandime konkrete për rishikimin e politikave për gjithpërfshirjen në arsim; • Numri i projekteve të realizuara.

Objektivi Specifik 1.1.4 Rritja e numrit të publikimeve shkencore të IPK-së në revista të indeksuara ndërkombëtare

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i temave me prioritet dhe përgatitja e punimeve për publikim; 2. Ngritja dhe funksionalizimi i një ekipi të IPK-së për mbështetjen e stafit në procesin e aplikimit për publikim në revistat e indeksuara ndërkombëtare; 3. Krijimi i një fondi për të subvencionuar tarifat e publikimit dhe shpenzimet editoriale për revistat e indeksuara ndërkombëtare; 4. Funksionalizimi i databazës së projekteve dhe publikimeve të stafit.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Lista me temat prioritare; Punimet e përgatitura për publikim; • Ekipi funksional i IPK-së për mbështetjen e stafit në procesin e aplikimit për publikim në revistat e indeksuara ndërkombëtare; • Fondi për subvencionimin e tarifave të publikimit, i aprovuar nga MASHTI; • Databaza e kërkimeve aktive, dhe e përditësuar.

Objektivi Specifik 1.1.5 Promovimi i punës kërkimore dhe rritja e vizibilitetit shkencor të IPK-së

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Organizimi i konferencës shkencore ndërkombëtare si aktivitet vjetor i IPK-së; 2. Organizimi i simpoziumeve dhe tryezave shkencore, vendore dhe ndërkombëtare; 3. Pjesëmarrja dhe kontributi shkencor në aktivitetet kërkimore-shkencore dhe profesionale të CIDREE; 4. Botimi i revistës Kërkime Pedagogjike dhe i publikimeve të veçanta të IPK-së; 5. Promovimi i punës kërkimore përmes faqes zyrtare të IPK-së, mediave dhe revistave të indeksuara.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Konferenca vjetore e organizuar; • Raporti i konferencës; • Raportet për ngjarjet e organizuara; • Raportet për pjesëmarrje dhe kontribut shkencor; • Revista e botuar; • Numri i publikimeve të veçanta; • Publikimet në faqen zyrtare të IPK-së; • Paraqitjet në media; • Publikimet në revistat e indeksuara;

Fusha Strategjike 2	Zhvillimi profesional-pedagogjik dhe shërbimet mbështetëse
Objektivi Strategjik 2.1	Përmirësimi i shërbimit profesional pedagogjik në funksion të rritjes së cilësisë së arsimit përmes zhvillimit të programeve profesionale, trajnimeve të specializuara, si dhe formave të tjera për zhvillim profesional për punonjësit e arsimit.

Ky objektivi strategjik ka një rol qendror në Planin Strategjik të Institutit Pedagogjik të Kosovës, pasi fokusohet në forcimin e zhvillimit profesional-pedagogjik dhe shërbimeve mbështetëse që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit në vend.

Përmirësimi i shërbimeve profesionale pedagogjike përmes programeve të avancuara, trajnimeve të specializuara dhe formave të tjera të zhvillimit profesional krijon një bazë të qëndrueshme për ngritjen e kompetencave të punonjësve të arsimit. Kjo jo vetëm që fuqizon kapacitetet e mësimit dhe profesionistëve të tjerë arsimorë, por edhe kontribuon në modernizimin e praktikave pedagogjike dhe përmirësimin e rezultateve të nxënësve.

Objektivi Specifik 2.1.1 Hartimi dhe zbatimi i programit mbështetës për ofrimin e mbështetjes profesionale-pedagogjike për DKA-të dhe shkollat

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza dhe vlerësimi i gjendjes lidhur me kapacitetet e DKA-ve dhe të shkollave për ofrimin e shërbimit mbështetës profesional-pedagogjik; 2. Përgatitja e strategjisë trevjeçare së bashku me MASHTI-n dhe DKA-të për ngritjen e kapaciteteve komunale për ofrimin e shërbimit mbështetës profesional-pedagogjik; 3. Hartimi i dokumentacionit, procedurave dhe rregulloreve përkatëse për funksionimin e qëndrueshëm të shërbimit mbështetës profesional-pedagogjik në DKA dhe shkolla; 4. Zhvillimi i programit për ngritjen e kapaciteteve në nivel të DKA-ve për ofrimin e shërbimit mbështetës profesional-pedagogjik; 5. Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve në nivel të DKA-ve për ofrimin e shërbimit mbështetës profesional-pedagogjik.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i vlerësimit të gjendjes; • Strategjia trevjeçare e dakorduar; • Dokumentacioni, procedurat dhe rregulloret përkatëse të hartuara; • Programi i zhvilluar; • Numri i trajnimeve të organizuara në nivel të DKA-ve;

Objektivi Specifik 2.1.2 Zhvillimi i një sistemi të vazhdueshëm për mentorim, monitorim dhe vlerësim të performancës së stafit arsimor dhe menaxhues të shkollave

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e qasjeve dhe metodave ekzistuese të MASHTI-t, Inspektoratit të Arsimit, DKA-ve dhe shkollave për realizimin e mentorimit, monitorimit dhe vlerësimit të performancës së shkollave; 2. Rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kornizës, i udhëzuesve dhe udhëzimeve për mentorim, monitorim dhe vlerësim të performancës së shkollave; 3. Trajnimi i ekipeve përgjegjëse për vlerësimin e performancës në nivel të shkollave; 4. Organizimi i tryezave, simpoziumeve dhe sesioneve reflektuese midis mësimdhënësve, drejtorëve dhe DKA-ve; 5. Marrja e informatave vjetore dhe raportimi lidhur me përvojat, gjetjet dhe nevojën për përmirësimin e sistemit për mentorim, monitorim dhe vlerësim të performancës së shkollave.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i vlerësimit të gjendjes; • Udhëzuesit për mentorim, monitorim dhe vlerësim të performancës së shkollave, të rishikuar;

- Trajnimet e organizuara për ekipet përgjegjëse;
- Së paku nga një tryezë/ simpozium dhe/apo sesion reflektues i organizuar në vit për këtë qëllim;
- Raporti vjetor dhe rekomandimet për përmirësim të mëtutjeshëm;

Objektivi Specifik 2.1.3 Zhvillimi i programeve të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve, drejtorëve dhe punonjësve arsimorë në fushat prioritare kombëtare

Aktivitetet kryesore

1. Hartimi i planit dyvjeçar bazuar në nevoja dhe prioritete strategjike;
2. Hartimi i programeve të trajnimit dhe aprovimi nga MASHTI;
3. Trajnimi i trajnerëve në fushat prioritare dhe certifikimi i tyre;
4. Organizimi i trajnimeve në bashkëpunim me DKA-të, shkollat dhe partnerët relevantë;
5. Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve në performancën e mësimdhënësve;
6. Raportimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programeve.

Treguesit e suksesit

- Plani dyvjeçar i hartuar dhe aprovuar;
- Plani dyvjeçar i publikuar;
- Programet e trajnimit, të hartuara;
- Programet e aprovuara nga MASHTI;
- Trajnerët e trajnuar;
- ≥50 trajnerë të certifikuar;
- ≥500 mësimdhënës të trajnuar;
- Trajnimet e realizuara sipas planit;
- Raport vlerësimi i hartuar;
- Evidencë e rritjes së kompetencave të pjesëmarrësve;
- Raportet vjetore të progresit;
- Përmirësime të integruara në programe çdo vit;

Objektivi Specifik 2.1.4 Rritja e kapacitetit profesional të stafit të IPK-së për ofrimin e mbështetjes profesionale-pedagogjike për shkollat dhe DKA-të

Aktivitetet kryesore

1. Hartimi dhe zbatimi i programeve të brendshme të zhvillimit profesional për stafin e IPK-së (mentorimi pedagogjik, analiza e të dhënave, menaxhimi i cilësisë, dizajnimi i programeve të trajnimit, përdorimi i mjeteve digjitale për mbështetje shkollore);
2. Organizimi i punëtorive të brendshme sipas temave prioritare;
3. Krijimi i databazës së materialeve, manualeve, udhëzimeve dhe praktikave të mira;
4. Krijimi i një sistemi të komunikimit të brendshëm për shfrytëzim, përditësim dhe pasurim të databazës me materiale praktike për zhvillim të vazhdueshëm;

5. Trajnime në aftësi të avancuara të komunikimit dhe këshillimit profesional (feedback profesional konstruktiv, këshillimi pedagogjik, zhvillimi i kapaciteteve të shkollave për planifikim).

Treguesit e suksesit

- Programet e zhvillimit profesional, të hartuara dhe të zbatuara;
- ≥80% e stafit të trajnuar;
- ≥4 punëtori të organizuara çdo vit;
- Pjesëmarrje e rregullt e stafit (>75%);
- Databaza funksionale dhe e qasshme;
- ≥100 materiale të ngarkuara;
- Sistem i komunikimit funksional me azhurnime mujore;
- Përdorim aktiv i sistemit nga stafi;
- ≥70% e stafit të trajnuar;
- Rritje e performancës së stafit (e matshme përmes vlerësimeve vjetore).

Objektivi Specifik 2.1.5 Integrimi i teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale në programet e trajnimit dhe aktivitetet profesionale, me theks të veçantë në lexim-kuptim, lexim-shkrim dhe mendim kritik e kreativ

Aktivitetet kryesore

1. Digjitalizimi i përmbajtjeve të programit/udhëzuesit për lexim-kuptim, lexim-shkrim dhe mendim kritik e kreativ;
2. Përgatitja e udhëzuesve për mësimdhënës për përdorim të inteligjencës artificiale në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
3. Ngritja e kapaciteteve të stafit të IPK-së dhe bashkëpunëtorëve/trajnerëve për ofrimin e programit me mësimdhënës;
4. Zhvillimi i platformës/programit për përdorim të lehtë dhe pasurim me materiale dhe shembuj nga praktika gjatë mësimdhënies;
5. Ngritja e sistemit për monitorim, vlerësim dhe raportim për ndikimin e këtyre përmbajtjeve digjitale në performancën e mësimdhënësve dhe rezultatet e nxënësve.

Treguesit e suksesit

- Materialet e digjitalizuara;
- ≥90% e përmbajtjeve të integruara në format digjital;
- Udhëzuesi i hartuar dhe publikuar;
- ≥50% staf dhe trajnerë të trajnuar;
- Trajnime të dokumentuara;
- Platforma funksionale;
- Përdorim aktiv nga mësimdhënësit;
- Sistemi i monitorimit i funksionalizuar;
- Raportet vjetore të ndikimit të programeve;
- Evidenca e përmirësimit të rezultateve;

Fusha Strategjike 3	Menaxhimi institucional dhe administrimi efektiv
Objektivi Strategjik 3.1	Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës, përfundimi i kapaciteteve administrative dhe menaxheriale dhe hartimi i akteve nënligjore sipas legjislacionit në fuqi.

Ky objektivi strategjik është thelbësor për Planin Strategjik të Institutit Pedagogjik të Kosovës, pasi synon të sigurojë një menaxhim institucional dhe administrim efektiv, që shërben si themeli i funksionimit të qëndrueshëm të institucionit.

Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës, forcimi i kapaciteteve administrative dhe menaxheriale, si dhe hartimi i akteve nënligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, garanton një mjedis profesional dhe efikas pune. Ky objektivi mbështet funksionimin e rregullt të proceseve akademike dhe administrative, rrit përgjegjshmërinë institucionale dhe krijon bazën për implementimin e politikave strategjike të IPK-së, duke përmirësuar kështu cilësinë e shërbimeve dhe reputacionin e institucionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Objektivi Specifik 3.1.1 Funkcionalizimi i objektit të ri të IPK-së me hapësira për konferenca, simpoziume dhe aktivitete profesionale

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Marrëveshja me Qeverinë e Kosovës për sigurimin e hapësirave publike për shfrytëzim nga IPK-ja; 2. Fillimi i punimeve të objektit të ri të IPK-së, instalimeve teknike dhe infrastrukturës; 3. Pajisja e sallave me teknologji bashkëkohore (audio-vizuale, internet, pajisje prezantimi); 4. Zhvendosja e stafit dhe infrastrukturës ekzistuese të IPK-së pas përfundimit dhe funksionalizimit të objektit të ri; 5. Promovimi publik dhe zyrtar i hapësirave për bashkëpunim ndërinstitucional.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Marrëveshja e nënshkruar; • Punimet e nisura sipas planit; • Salla të pajisura 100%; • Testimet teknike të përfunduara; • Zhvendosja e përfunduar; • Raport për funksionalizim të plotë; • Ceremonia promovuese e realizuar; • Salla të hapura për bashkëpunim ndërinstitucional;

Objektivi Specifik 3.1.2 Rekrutimi i stafit përkatës në Departamentin për Mbështetje Profesionale-pedagogjike

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i nevojave për staf shtesë sipas strukturës organizative; 2. Hartimi i përshkrimeve të detyrave të punës; 3. Përzgjedhja, me konkurs dhe trajnimi i stafit të ri (kurrikulë, vlerësim, zhvillim profesional, digjitalizim etj.); 4. Përfshirja e stafit të ri në projekte kërkimore dhe aplikime ndërkombëtare; 5. Hartimi i normës vjetore të punës shkencore dhe profesionale të stafit të IPK-së.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Lista e specialistëve të identifikuar, e miratuar nga MASHTI dhe DMZP-ja; • Përshkrimet e punës të finalizuara; • Konkursi publik i shpallur; • 8 specialistë të angazhuar dhe të trajnuar; • Raport për trajnimin e përfunduar; • Stafi i ri i integruar në projekte kërkimore dhe projekte ndërkombëtare; • Norma vjetore e punës, e hartuar dhe e miratuar.

Objektivi Specifik 3.1.3 Fuqizimi i statusit dhe rolit të IPK-së si institucion me rëndësi të veçantë në kuadër të Ligjit të ri për VKSHI

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analizimi i kornizës ligjore dhe hartimi i propozimeve/rekomandimeve për përfshirje në Projektligjin për VKSHI; 2. Pjesëmarrje në grupet punuese për ligje dhe udhëzime administrative; 3. Hartimi i statutit të ri të IPK-së në përputhje me legjislacionin e ri për VKSHI; 4. Aprovimi dhe publikimi i statutit të ri.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Raporti dhe rekomandimet nga analiza ligjore; • Propozimet për amendamente ligjore adekuate; • Vendimi zyrtar nga MASHTI për përfshirjen e IPK-së në grupet punuese; • Procesverbalet e pjesëmarrjes; • Statuti i ri i miratuar; • Publikimi në faqen zyrtare të IPK-së;

Objektivi Specifik 3.1.4 Hartimi dhe zbatimi i akteve të reja nënligjore për avancimin e punës kërkimore dhe profesionale-pedagogjike

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Formimi i grupeve punuese për hartimin e rregulloreve të brendshme dhe akteve të tjera juridike; 2. Hartimi i rregulloreve të brendshme dhe akteve të tjera juridike sipas ligjeve dhe Statutit; 3. Miratimi i akteve nënligjore nga Këshilli Drejtues i IPK-së; 4. Raportimi vjetor për zbatimin e kornizës ligjore.
Treguesit e suksesit
<ul style="list-style-type: none"> • Vendimi për formimin e grupeve punuese; • Lista e anëtarëve; • Paketë e plotë draft-rregulloresh dhe aktesh juridike; • Vendimet e miratimit; • Aktet e nënshkuara; • Raportet vjetore të dërguara në MASHTI dhe KD.

Fusha Strategjike 4	Partneriteti dhe rrjetëzimi strategjik
Objektivi Strategjik 4.1	Forcimi i bashkëpunimit strategjik me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe krijimi i rrjeteve me aktorët relevantë për të përmirësuar ndikimin e IPK-së në zhvillimin e arsimit dhe projekteve kërkimore-shkencore dhe profesionale.

Ky objektivi strategjik është thelbësor për Strategjinë e Institutit Pedagogjik të Kosovës, pasi fokusohet në ndërtimin e partneriteteve dhe rrjetëzimin strategjik, që rrisin ndikimin dhe prezencën e institucionit në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Forcimi i bashkëpunimit me institucionet arsimore, organizatat profesionale dhe aktorët e tjerë relevantë mundëson shkëmbimin e eksperiencave, përfshirjen në projekte kërkimore-shkencore dhe profesionale, si dhe promovimin e inovacionit dhe praktikave të mira në arsim. Krijimi i rrjeteve strategjike kontribuon në avancimin e reputacionit të IPK-së, zgjeron mundësitë për financim dhe bashkëpunim, si dhe e vendos institutin si një aktor kyç në zhvillimin e politikave dhe praktikave arsimore në Kosovë dhe jashtë saj.

Objektivi Specifik 4.1.1 Arritja e marrëveshjeve të partneritetit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare

Aktivitetet kryesore
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e nevojave dhe fushave prioritare për bashkëpunim; 2. Krijimi i listës së institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për themelimin të partneritetit;

3. Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit;
4. Krijimi i një ekipi të brendshëm për koordinim të projekteve ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare;
5. Zhvillimi i procedurave standarde për monitorim dhe realizim të marrëveshjeve.

Treguesit e suksesit

- Raporti i analizës së nevojave;
- Lista/databaza e partnerëve strategjikë;
- Marrëveshjet e arritura;
- Vendimi për themelimin e procedurave standarde për monitorimin e realizimit të marrëveshjeve;
- Ekipi funksional.

Objektivi Specifik 4.1.2 Sigurimi i pjesëmarrjes së IPK-së në programe ndërkombëtare

Aktivitetet kryesore

1. Krijimi i ekipit përgjegjës ad hoc për projekte ndërkombëtare (Erasmus+, Horizon Europe etj.);
2. Identifikimi dhe krijimi i partneriteteve vendore dhe ndërkombëtare;
3. Trajnime për stafin mbi procedurat e aplikimit në projekte dhe programe ndërkombëtare;
4. Hartimi dhe dorëzimi i aplikimeve sipas kërkesave të identifikuara.

Treguesit e suksesit

- Ekipi për menaxhimin e projekteve, i formuar dhe funksional;
- Lista e partnerëve të identifikuar;
- Marrëveshje bashkëpunimi për programe;
- Sesione trajnuese të realizuara;
- Numri i aplikimeve të dorëzuara;
- Projekte të miratuara;

Objektivi Specifik 4.1.3 Rritja e përfshirjes aktive të IPK-së në rrjetet profesionale dhe në organizatat vendore e ndërkombëtare si ALE NK, EERA, CIDREE, ENIRDELM, EfVET etj.

Aktivitetet kryesore

1. Caktimi i kriterëve dhe procedurave për pjesëmarrjen e stafit të IPK-së në rrjetet ndërkombëtare sipas planit të punës;
2. Pjesëmarrja aktive në rrjetet dhe partneritetet vendore dhe ndërkombëtare (p.sh. ALE NK, EERA, CIDREE, etj);

3. Pjesëmarrja e rregullt në punëtoritë dhe konferencat vendore dhe ndërkombëtare për rrjetëzim;
4. Prezantimi i praktikave të mira përmes raportit dhe publikimeve në faqen e IPK-së.

Treguesit e suksesit

- Dokumenti i kriterëve dhe procedurave, i miratuar;
- Numri i prezantimeve dhe pjesëmarrjeve;
- Raportimi publik i aktiviteteve;

Objektivi Specifik 4.1.4 Forcimi i bashkëpunimit me institucionet kërkimore-shkencore shqiptare në rajon përmes zhvillimit të projekteve të përbashkëta

Aktivitetet kryesore

1. Identifikimi i institucioneve homologe me prioritet për bashkëpunim rajonal;
2. Arritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit;
3. Përcaktimi i temave kërkimore prioritare dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta;
4. Zhvillimi i studimeve krahasuese rajonale dhe botimeve të përbashkëta;
5. Organizimi i konferencave të përbashkëta rajonale.

Treguesit e suksesit

- Lista e institucioneve homologe;
- Marrëveshjet e nënshkuara;
- Agjenda e temave;
- Aktivitetet e përbashkëta të zhvilluara;
- Raportet e publikuara;
- Artikujt/monografitë e përbashkëta;
- Konferencat e realizuara dhe numri i pjesëmarrësve;
- Publikimet e konferencës;

ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Zbatimi i Planit Strategjik

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e Planit Strategjik 2026–2030 i takon vetë Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK). Instituti është aktori kryesor që udhëheq të gjitha proceset, siguron koordinimin dhe monitorimin e veprimeve dhe garanton realizimin e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. IPK do të veprojë në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), si dhe me institucionet arsimore, komunat, agjencitë, institutet, partnerët zhvillimorë dhe organizatat donatore, duke harmonizuar aktivitetet dhe përdorimin efektiv të burimeve.

Në kuadër të strukturës organizative të IPK-së do të krijohet një Grup për Zbatimin e Planit Strategjik, i cili do të drejtohet nga drejtori i Institutit dhe do të përfshijë përfaqësues nga të gjitha njësitë përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve strategjike. Ky grup ka përgjegjësi të hartojë planet vjetore të veprimit, të menaxhojë burimet, të analizojë progresin dhe të propozojë masa korrigjuese ose plotësuese për të siguruar realizimin e objektivave. Takimet e grupit do të mbahen rregullisht, ndërsa në periudha të caktuara do të organizohen takime të zgjeruara, me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve relevantë.

Monitorimi

Monitorimi është një proces i vazhdueshëm brenda IPK-së, i cili siguron informacion të saktë dhe të përditësuar mbi progresin e zbatimit të strategjisë dhe efektivitetin e aktiviteteve.

Ky proces realizohet në dy nivele:

1. Monitorimi i aktiviteteve – IPK verifikon nëse aktivitetet janë kryer në kohë dhe me cilësinë e duhur, duke përdorur Planin e Veprimit pesëvjeçar si mjet kryesor. Çdo devijim nga plani analizohet dhe, kur është e nevojshme, bëhet përshtatja e afateve dhe e burimeve për të ruajtur harmoninë e aktiviteteve. Burimet njerëzore, financiare dhe materiale monitorohen vazhdimisht për të siguruar realizimin e veprimeve sipas planit.
2. Monitorimi i objektivave bazohet në treguesit matës të objektivave strategjike dhe specifike të IPK-së. Synimet afatshkurtra dhe afatmesme përcaktohen në planet vjetore të punës dhe krahasohen me vlerat aktuale për të nxjerrë përfundime mbi progresin e arritur dhe për të identifikuar nevojën për ndërhyrje të mëtejshme.

Raportimi është pjesë integrale e procesit të monitorimit dhe realizohet në dy forma:

- Raporti gjashtëmujor, që përmbledh progresin e periudhës gjashtëmujore, përqendrohet në zbatimin e aktiviteteve, identifikon arsyet për vonesa, rreziqet dhe sugjeron hapat e ardhshëm për përmirësimin e zbatimit.
- Raporti vjetor i realizimit të Planit Strategjik, që përgatitet në fillim të vitit pasues dhe përfshin edhe gjashtëmujorin e dytë të vitit, ofron një pasqyrë të plotë të realizimit të objektivave, përdorimit të burimeve, pengesave dhe masave korrigjuese, si dhe sugjerimeve për përmirësime të ardhshme.

Vlerësimi i Planit Strategjik

Vlerësimi i Planit Strategjik është një proces më i thellë, i cili e lejon IPK-në të analizojë efektivitetin dhe ndikimin e aktiviteteve të ndërmarra. Ai përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, shqyrtimin e rezultateve, identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në sukses ose dështim, si dhe formulimin e rekomandimeve për ripërshtatjen e drejtimit strategjik në përputhje me rrethanat.

Për të siguruar objektivitetin dhe pavarësinë e vlerësimit, IPK do të angazhojë ekspertë të jashtëm gjatë periudhës së strategjisë: pas përfundimit të vitit të dytë, të katërt dhe të pestë. Vlerësimet do të përfshijnë dimensionet kryesore: relevancën, efektivitetin, efikasitetin, cilësinë e zbatimit, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e rezultateve. Raportet tremujore dhe vjetore të progresit të mbledhura nga IPK-ja do të përdoren si burim kryesor informacioni për këto vlerësime.

Ky mekanizëm i integruar i zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit, me IPK-në në qendër të procesit, siguron që Plani Strategjik 2026–2030 të realizohet në mënyrë efektive, të rrisë ndikimin e Institutit në arsimin vendor dhe ndërkombëtar dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve pedagogjike dhe kërkimore.

Përmbledhje e planit të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të Planit Strategjik

Fusha	Përshkrimi	Përgjegjësit	Afati / Shpeshtësia	Burimet / Mjetet
Zbatimi i Planit Strategjik	IPK ka përgjegjësinë primare për zbatimin e Planit Strategjik. Instituti koordinon aktivitetet me MASHTI-n, institucionet arsimore, komunat, agjencitë dhe partnerët zhvillimorë.	Drejtori i IPK-së, Grupi për Zbatimin e Planit Strategjik, njësitë përgjegjëse	Gjatë gjithë periudhës 2026–2030	Buxheti i Institutit, burimet njerëzore, partnerët dhe donatorët
Grupi për Zbatimin e Planit Strategjik	Harton planet vjetore të veprimit, menaxhon burimet, analizon progresin dhe propozon masat plotësuese. Mbledhjet e rregullta, takimet e zgjeruara me aktorët relevantë.	Drejtori i IPK-së, përfaqësues nga njësitë përgjegjëse	Takime të rregullta (minimum 1 herë në 3 muaj); takime të zgjeruara (2 herë në vit)	Dep. për Shërbime, buxheti i IPK-së, mbështetje teknike
Monitorimi i aktiviteteve	Kontrollon kryerjen në kohë dhe cilësinë e aktiviteteve sipas Planit pesëvjeçar. Devijimet analizohen dhe bëhet përshtatja e afateve dhe burimeve.	Njësitë përkatëse brenda IPK-së, Grupi i Zbatimit	Vazhdues/çdo 3 muaj	Plani i Veprimit, raportet e progresit, burimet njerëzore dhe materiale
Monitorimi i objektivave	Mat progresin e objektivave strategjike dhe specifike përmes treguesve të përcaktuar; përcaktohen synimet vjetore dhe afatmesme.	Njësitë përgjegjëse brenda IPK-së	Vjetor, pjesë e planeve vjetore të punës	Treguesit e performancës, bazat e të dhënave, raportet gjashtë mujore dhe vjetore
Raportimi gjashtëmujor	Përmbledh progresin gjashtëmujor, identifikon vonesat, rreziqet dhe hapat e ardhshëm për përmirësim.	Grupi për Zbatimin e Planit Strategjik, njësitë përgjegjëse	Çdo gjashtë muaj	Raportet e progresit, burimet njerëzore dhe financiare
Raportimi vjetor	Pasqyron realizimin e objektivave, përdorimin e burimeve, pengesat dhe masat korrektuese.	Grupi për Zbatimin e Planit Strategjik, Drejtori	Çdo vit, në fillim të vitit pasues	Raportet gjashtëmujore, bazat e të dhënave, buxheti i Institutit

Vlerësimi i Planit Strategjik	Analizon suksesin dhe ndikimin e zbatimit, identifikon faktorët e suksesit ose dështimit dhe rekomandon ripërshatjen strategjike. Përdoren raportet gjashtëmujore dhe vjetore. Përfshihen vlerësime të jashtme në vitet 2, 4 dhe 5/6.	Drejtori i IPK-së, partnerët zhvillimorë/ekspertët e jashtëm, Grupi për Vlerësim	Tri vlerësime të jashtme: pas viteve 2, 4 dhe 5/6	Raportet e progresit, të dhënat e mbledhura nga terreni, analizat e ekspertëve, partnerët ndërkombëtarë
Dimensionet e vlerësimit	Relevanca, efektiviteti, efikasiteti, cilësia e zbatimit, ndikimi dhe qëndrueshmëria e rezultateve.	Grupi i Vlerësimit i IPK-së	Pas çdo vlerësimi të jashtëm	Raportet gjashtëmujore dhe vjetore, të dhënat nga terreni, ekspertët

BURIMET DHE FINANCIMI

Zbatimi i Planit Strategjik të Institutit Pedagogjik të Kosovës 2026–2030 mbështetet në një qasje të qëndrueshme dhe të planifikuar të menaxhimit financiar, duke u bazuar në burimet ekzistuese dhe ato të planifikuara në përputhje me prioritetet e Strategjisë së Arsimit të Kosovës. Për të siguruar realizimin efektiv të objektivave strategjike, IPK-ja do të përdorë një kombinim burimesh financiare, të cilat përfshijnë financimin bazë nga MASHTI, fondet e siguruara përmes projekteve bashkëpunuese ndërkombëtare, si dhe burimet e mundshme nga partneritetet profesionale dhe mbështetjet teknike.

Burimet financiare ekzistuese të ofruara nga MASHTI do të vazhdojnë të mbështesin funksionet themelore të Institutit, duke përfshirë aktivitetet kërkimore, zhvillimin profesional, menaxhimin institucional dhe investimet në infrastrukturë. Ndërkohë, burimet e planifikuara synojnë zgjerimin e kapaciteteve të IPK-së në përputhje me politikat kombëtare të financimit, të cilat theksojnë transparencën, efikasitetin dhe orientimin drejt cilësisë në arsim. Në këtë kontekst, prioritet mbetet siguri i investimeve të qëndrueshme që e fuqizojnë IPK-në si institucion udhëheqës në zhvillimin e standardeve dhe praktikave arsimore.

Partneritetet me organizata ndërkombëtare, agjenci zhvillimore dhe institucione të arsimit të lartë do të luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e burimeve shtesë financiare dhe teknike. Këto bashkëpunime do të kontribuojnë në realizimin e projekteve kërkimore, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe avancimin e proceseve të digjitalizimit dhe inovacionit pedagogjik. Harmonizimi me prioritetet e financimit të Strategjisë së Arsimit të Kosovës siguron që mbështetja ndërkombëtare të orientohet drejt fushave me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësi dhe barazi në arsim.

Menaxhimi i qëndrueshëm financiar mbetet themeli i zbatimit të këtij Plani Strategjik. IPK-ja do të zhvillojë mekanizma të brendshëm të menaxhimit dhe raportimit financiar, duke garantuar përdorim efikas, të përgjegjshëm dhe transparent të fondeve. Përmes planifikimit afatgjatë dhe koordinimit të ngushtë me MASHTI-n dhe partnerët ndërkombëtarë, Instituti synon të sigurojë stabilitet financiar, rritje të kapaciteteve dhe një mjedis të favorshëm për realizimin e objektivave strategjike që kontribuojnë në transformimin e sistemit arsimor të Kosovës.

Buxheti i Planit Strategjik të IPK-së¹

Kategoria ekonomike	Totali 2026-2030 (€)	Viti 2026 (€)	Viti 2027 (€)	Viti 2028 (€)	Viti 2029 (€)	Viti 2030 (€)
Paga, shtesa dhe kompensime	2,021,054.00	331,054.00	400,000.00	430,000.00	430,000.00	430,000.00
Mallra dhe shërbime	959,000.00	179,500.00	179,500.00	200,000.00	200,000.00	200,000.00
Shpenzime komunale	107,615.00	21,523.00	21,523.00	21,523.00	21,523.00	21,523.00
Subvencione dhe Transfere	250,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
Totali	3,337,669.00	582,077.00	651,023.00	701,523.00	701,523.00	701,523.00

¹ Buxheti është i bazuar në PCF1 për 2026-2028, e cila ende nuk është aprovuar me Ligjin e Buxhetit. Prandaj, do të modifikohet çdo vit, në varësi të vendimeve dhe aprovimeve përkatëse buxhetore.

SHTOJCAT

- A. Grupi Punues
- B. Plani i Veprimit
- C. Referenca të materialeve, publikimeve dhe dokumenteve ligjore

SHTOJCA A: GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT STRATEGJIK

Shprehim falënderimet më të sinqerta për grupin punues që hartoi Strategjinë e Institutit Pedagogjik të Kosovës për periudhën 2026–2030. Përkushtimi, profesionalizmi dhe bashkëpunimi i tyre kanë qenë thelbësorë për zhvillimin e një dokumenti strategjik të qartë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, i cili do të udhëheqë Institutin drejt avancimit të arsimit dhe rritjes së cilësisë në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Grupi punues që ka kontribuar në hartimin e këtij Plani Strategjik (renditur në mënyrë alfabetike në tabelën në vijim) përfshin anëtarët e KD-së, anëtarët e KSH-së, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve të IPK-së, stafin administrativ dhe menaxherial si dhe konsulentin e grupit.

Emri dhe mbiemri	Pozita
Agim Bujari	Hulumtues i pavarur
Bashkim Azemi	Hulumtues
Bekim Morina	Hulumtues i pavarur
Dorajet Imeri	Anëtar i Këshillit Drejtues
Fitore Maliqi	Udhëheqëse e sektorit për shërbime të përbashkëta
Fjolla Kaçaniku	Anëtare e Këshillit Shkencor
Luljeta Shala	Hulumtuese e pavarur
Magbule Mejzini	Anëtare e Këshillit Drejtues
Mevlude Aliu-Gashi	Hulumtuese e pavarur
Murteza Osdautaj	Bashkëpunëtor shkencor dhe Sekretar shkencor
Naser Zabeli	Anëtar i Këshillit Shkencor
Osman Buleshkaj	Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës
Safete Shala	Bashkëpunëtoreshkencore
Tringa Dedi	Bashkëpunëtoreshkencore
Valmira Haxhaj-Gushlla	Konsulente dhe fasilituese e procesit në zhvillimin e këtij Plani Strategjik, e angazhuar nga GIZ-i
Valon Gajraku	Zyrtar i Lartë Ligjor

SHTOJCA B: PLANI I VEPRIMIT**Fusha Strategjike 1: Huluntimi, inovacioni dhe reputacioni ndërkombëtar**

Objektivi Strategjik 1.1: Rritja dhe avancimi i kërkimit shkencor dhe inovativ të IPK-së si dhe forcimi i reputacionit vendor dhe ndërkombëtar përmes bashkëpunimeve të reja, publikimeve, digjitalizimit, promovimit të punës kërkimore-shkencore dhe pjesëmarrjes në projekte shkencore

Objektivi Specifik	Aktivitetet Kryesore	Afati kohor	Përgjegjësit	Burimet	Treguesit e suksesit
